



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi.org

Nr. 176/09 dt. 24. 7. 2009

Për: Kolegjin AAB RIINVEST

Mbështetur në LAL 2/2003 dhe Udhëzimet administrative që dalin nga ky ligj: UA 14/2003 për Licencimin e institucioneve private të arsimit të lartë në Kosovë, UA 11/2004 për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, UA 1/2009 për Akreditimin e Institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë dhe UA 12/2009 mbi kriteret dhe procedurat për akreditimin e Shkollave të larta profesionale dhe Shkollave të larta teknike në Kosovë), dëshiroj t'ju njoftoj se Këshilli Kombëtar i Cilësisë i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës ka shqyrtuar aplikacionin tuaj për akreditim dhe ka vendosur si në vijim:

Programet e akredituara

Programet

- Ekonomiks Biznesi (në nivel Bachelor – BSc)
- Programi Banka Financa dhe Kontabilitet (në nivel Bachelor – BSc)
- Programi Menaxhment dhe Informatikë (ne nivel Bachelor-BSc dhe MSc)
- Programi Marketing dhe administrim Biznesi (ne nivel Bachelor-BSc)
- Programi Zhvillim i Financave (ne nivel Master-MSc)
- Programi Tregjet Financiare dhe Bankat (ne nivel Master-MSc)
- Programi Shkenca Kompjuterike-Inxhinieri Softuerike (ne nivel Bachelor-BSc)
- Programi Juridik i Përgjithshëm (në nivel Bachelor-BSc)
- Programi Komunikim Masiv- Gazetari (në nivel Bachelor-BSc)
- Programi Komunikim Masiv- Produksion (në nivel Bachelor-BSc)
- Programi Kulture Fizike dhe Sport (në nivel Bachelor-BSc)

do të akreditohen për një vit në rastin e parë (1 Tetor 2009-30 Shtator 2010) me kushtet vijuese që duhet plotësuar gjer më 1 Shtator 2009:

1. Të ofrohen dëshmi se janë harmonizuar plotësisht programet e studimit që ofrohen pas shkrirjes së institucioneve në një institucion me strukturë të përbashkët akademike.
2. Të dëshmohet se institucioni posedon burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale (hapsirë, bibliotekë dhe paisje për mësimdhënje) për funksionimin e degëve jashtë qendrës
3. Të përmirësohet dukshëm furnizimi i bibliotekës me tituj mësimor për lëndët bazike në fushat e ofruara të studimit dhe me revista shkencore në gjuhën angleze
4. Të dorëzohet në AAK Plani i përmirësimit të cilësisë në institucion (fellow up) i përpiluar në bazë të rekomandimeve të Ekipit të ekspertëve që duhet të përmbushen gjer në vizitën e ardhshme.

Programet që nuk do të akreditohen

Programet :

Programi i Shkencave të Kriminalistikës
Programi Edukim- Departamenti parafillor
Programi Edukim -Departamenti fillor
Programi i Përgjithshëm (Pedagogjik) ne edukim muzikor
Programi i Solo-këndimit
Programi i Pianos
Programi Arkitekture
Programi Dizajn enterieri
Programi i Dizajnit Grafik
Programi i Pikturës
Programi i Fotografisë
Programi i Grrimit
Programi Administrim Publik
Programi i Gjuhës Angleze
Programi Aktrim dhe regji

nuk akreditohen dhe nuk duhet të regjistrohen studentë të rinj.

Akreditimi institucional

Akreditimi si Kolegj

Ju mund të pranoni studentë në programet e akredituara më lartë që fillojnë më 1 tetor 2009, por nuk mund të pranoni studentë në programet e pa akredituara. Duhet të siguroni se çdo student i pranuar në njërin nga programet e akredituara është regjistruar në

njërën prej gradave akademike të ofruara më lartë. Nuk lejoheni që të shpallni konkurs në asnjërin nga programet e pa akredituara, pa marrë parasysh a është specifikuar më lartë apo jo.

Studentët të cilët momentalisht ndjekin studimet në një program të paakredituar duhet të njoftohen për statusin e akreditimit të programit të tyre para se të regjistrohen në vitin akademik 2009-10

Ju duhet të siguroni se çdo kusht për akreditim i cili është specifikuar më lartë do të plotësohet gjer në datën e caktuar. Ne do të shqyrtojmë përgjegjen tuaj dhe do të vendosim nëse edhe ndonjë vizitë e ekspertëve do të jetë e nevojshme. Nëse po, atëherë të gjitha shpenzimet e bëra do të mbulohen nga ju.

MASHT-i së shpejti do të hartojë një Udhëzim administrativ me të cilin do të kërkon nga ju që të ofroni emrat dhe shënimet tjera personale për studentë të cilët kanë përfunduar programet e akredituara, së bashku me Shtojcën e diplomës për çdo student, që do të na lejoj ne lëshuarjen e çertifikatës së Diplomës të mbështetur nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës për secilin student që ka diplomuar nga data 7 korrik 2009. Ftoheni që të sjellni te ne dizajnin e çdo çertifikate që dëshironi që ne ta lëshojmë për ju.

Ju gjithashtu ftoheni që të paraqitni aplikacionin për programme tjera të studimit (pa marrë parasysh a janë paraqitur më heret apo jo). Ne do të jemi në gjendje që të pranojmë këto aplikacione nga 1 Tetori 2009 e tutje. Ju përkujtojmë se të gjitha aplikacionet duhet të plotësojnë kërkesat nga UA 2/2009 ose UA 12/2009.

Studimet master

Qeveria e Republikës së Kosovës dëshiron që tui jap një mundësi që të ofroni programet e juaja të akredituara në nivelin master sa më parë që ju jeni në gjendje ta bëni këtë. Nëse dëshironi që ne të shqyrtojmë propozimet e juaja për këto grada, ju lusim që të aplikoni te ne gjer më datën 15 Shtator 2009. Ne do tui sigurojmë se aplikacioni i juaj do të shqyrtohet shpejtë dhe ju mund të filloni procesin e regjistrimit për këto grada pasi që KKC i AAK e aprovon aplikacionin tuaj.

Më lejoni që t'ju uroj për marrjen e akreditimit dhe shpresoj që të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen sepse ne punojmë së bashku që të përkrahim përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit të lartë në Kosovë.

Prishtinë, 24. 07.2009

Me respekt,
Basri Muja, u.d. Drejtor

